BANKA E SHQIPËRISË

BULETINI ZYRTAR

vëllimi 12 numër 2 mars 2010

Data e botimit 05.04.2010

P Ë R M B A J T J A

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 13, datë 10.03.2010 "Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë shtesë nga Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a." 5
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 10.03.2010 "Për miratimin e rregullores "Për vlerësimin e performancës në punë të punonjësve të Bankës së Shqipërisë"" 6
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr.15, datë 10.03.2010 "Për miratimin e "Kontratës - tip për riblerjen e titujve"" 21
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 16, datë 10.03.2010 "Për miratimin e procedurës së veçantë për prokurimin e objektit "Abonimi pranë një agjencie renditjeje"" 29
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 17, datë 10.03.2010 "Për miratimin e delegimit të kompetencës "Për nënshkrimin e dokumentacionit teknik në zbatim të marrëveshjes ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe shoqërisë "MasterCard International Inc"" 31
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 18, datë 10.03.2010 "Për një ndryshim në vendimin "Për miratimin e përdorimit të procedurës së prokurimit të drejtpërdrejtë për blerjen dhe marrjen me qira të ambienteve të reja për nevojat e Bankës së Shqipërisë"" 32
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 21, datë 24.03.2010 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes" 33
8. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 22, datë 24.03.2010 "Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë shtesë nga Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a." 34
9. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 23, datë 24.03.2010 "Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë shtesë nga Banka e Tiranës sh.a." 35

10. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, Vëllimi 12, Numër 1, Shkurt 2010 37

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr.13, datë 10.03.2010

PËR
PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË SHTESË NGA BANKA E PARË E INVESTIMEVE, ALBANIA SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja "a", nenit 43, shkronjat "c" dhe "e" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar, të nenit 23, pikat 1 dhe 3, nenit 24, pika 1, shkronja "ç", nenit 54, pika 2, shkronja "e" dhe nënpika "i" të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të nenit 45 të ligjit nr.9879, datë 21.02.2008 "Për titujt", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për kryerjen nga Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a. të veprimtarisë financiare shtesë, si më poshtë:
- "Ndërmjetësimi për transaksionet monetare të marrjes në kujdestari, shërbimet depozituese dhe të besimit".
2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të kryer ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës të Bankës së Parë të Investimeve, Albania sh.a., sipas pikës 1 të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI	KRYETARI
YLLI MEMISHA	ARDIAN FULLANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr.14, datë 10.03.2010

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS NË PUNË TË PUNONJËSVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "f" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, i ndryshuar, me propozim të Guvernatorit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Për vlerësimin e performancës në punë të punonjësve të Bankës së Shqipërisë", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të ngarkojë Departamentin e Burimeve Njerëzore dhe të gjitha njësitë organizative të Bankës së Shqipërisë, në qendër dhe në degë, me zbatimin e këtij vendimi.

3. Të ngarkojë Departamentin e Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, vendimi nr. 109, datë 24.12.2003 i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë "Mbi kriteret e vlerësimit të rezultateve në punë të punonjësve në Bankën e Shqipërisë" shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

SEKRETARI	KRYETARI
YLLI MEMISHA	ARDIAN FULLANI

RREGULLORE
"PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS NË PUNË TË PUNONJËSVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË"

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti dhe fusha e zbatimit

1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe kritereve për menaxhimin e performancës në Bankë dhe vlerësimin e rezultateve në punë të punonjësve.

2. Subjekt i kësaj rregulloreje janë të gjitha njësitë organizative të Bankës.

Neni 2
Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim:

a) të forcojë procesin e menaxhimit të performancës në Bankë, nëpërmjet përcaktimit të synimeve e objektivave, monitorimit të progresit të realizuar në përmbushjen e tyre dhe vlerësimit të rezultateve individuale në punë mbi këtë bazë;
b) të përmirësojë efektivitetin dhe efektshmërinë e Bankës, duke rritur vëmendjen drejt arritjes së rezultateve, cilësisë së shërbimit dhe besimit të publikut;
c) të ndihmojë drejtuesit e njësive organizative në përmbushjen e detyrave, nëpërmjet planifikimit paraprak të objektivave për t'u realizuar dhe ofrimit të informacionit lidhur me rezultatet e arritura;
d) të përmirësojë administrimin e brendshëm të Bankës, duke i konsideruar njësitë organizative përgjegjëse për arritjen e rezultateve të caktuara;
e) të ndihmojë në zhvillimin e karrierës së punonjësve dhe në identifikimin e nevojave për trajnim e tyre; dhe
f) të ndikojë në përmirësimin e vendimmarrjes në Bankë, duke ofruar informacion objektiv lidhur me realizimin e objektivave ligjorë dhe statutorë si dhe për efektivitetin dhe efikasitetin e veprimtarisë së saj.

Neni 3
Baza ligjore

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe në zbatim të:

a) Ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i

ndryshuar;

b) Rregullores "Për marrëdhëniet e punës të personelit të Bankës së Shqipërisë"; dhe

c) Akteve të tjera nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

Neni 4
Përkufizime

Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "menaxhim i performancës" është tërësia e proceseve që lidhen me:
   i) planifikimin strategjik dhe planifikimin e punës nga ana e njësive organizative të Bankës dhe me vendosjen e objektivave dhe synimeve,
   ii) monitorimin e vazhdueshëm të performancës së njësive organizative e të punonjësve të Bankës, për sa i përket progresit të realizuar në arritjen e objektivave dhe synimeve,
   iii) zhvillimin e aftësive të punonjësve, duke adresuar mangësitë e vërejtura gjatë procesit të planifikimit dhe monitorimit,
   iv) vlerësimin periodik të performancës së njësive organizative dhe të punonjësve të Bankës, përkundrejt synimeve të shprehura në strategjitë dhe në planet e punës, dhe
   v) shpërblimin e punonjësve sipas performancës dhe adresimin e performancës së pamjaftueshme.

b) "shpërblim" është shuma në të holla që mund t'i jepet çdo punonjësi bazuar në rezultatet individuale në punë, përkundrejt realizimit të objektivave e synimeve të vendit të punës dhe kontributit personal në performancën e njësisë organizative dhe të Bankës në përgjithësi, në përputhje me kriteret e përcaktuara në dispozitat e kësaj rregulloreje dhe aktet përkatëse nënligjore të nxjerra nga Këshilli Mbikëqyrës;

c) "shtesa mbi pagë" ka kuptimin e përcaktuar në nenin 9 të Rregullores "Për strukturën e pagave bazuar në klasifikimin e vendeve përkatëse të punës në Bankën e Shqipërisë";

d) "objektiv" është rezultati (produkti dhe/ose rezultati) që Banka, njësitë organizative dhe punonjësit planifikojnë të arrijnë brenda një periudhe kohe të caktuar, në përputhje me pikësynimet ligjore të Bankës së Shqipërisë;

e) "vetëvlerësim" është procesi nëpërmjet të cilit punonjësi vlerëson dhe diskuton, mbështetur mbi fakte, me eprorin e drejtpërdrejtë performancën e tij në punë;

f) "Banka" është Banka e Shqipërisë;

g) "njësi organizative" është njësia organizative e Bankës në përputhje me Statutin e saj dhe me strukturën administrative, të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës;

h) "DBNJ" është Departamenti i Burimeve Njerëzore;

i) "Komiteti" është Komiteti i Vlerësimit të Performancës, sipas

nenit 21 të kësaj rregulloreje;

j) "niveli i lartë i drejtimit" ka kuptimin e përcaktuar në nenin 2 të Rregullores "Për strukturën e pagave bazuar në klasifikimin e vendeve përkatëse të punës në Bankën e Shqipërisë";

k) "niveli i ulët i drejtimit" ka kuptimin e përcaktuar në nenin 2 të Rregullores "Për strukturën e pagave bazuar në klasifikimin e vendeve përkatëse të punës në Bankën e Shqipërisë";

l) "niveli i shërbimit profesional" ka kuptimin e përcaktuar në nenin 2 të Rregullores "Për strukturën e pagave bazuar në klasifikimin e vendeve përkatëse të punës në Bankën e Shqipërisë";

m) "niveli i shërbimit të përgjithshëm" ka kuptimin e përcaktuar në nenin 2 të Rregullores "Për strukturën e pagave bazuar në klasifikimin e vendeve përkatëse të punës në Bankën e Shqipërisë".

KREU II
PLANIFIKIMI I PUNËS

Neni 5
Planet strategjike

1. Me kërkesë të Komitetit çdo njësi organizative paraqet propozimet për planin strategjik të Bankës, të cilat përmbajnë:

a) misionin e njësisë organizative, i cili përmbledh funksionet dhe detyrat kryesore të tij;

b) synimet dhe objektivat për funksionet dhe detyrat kryesore të njësisë organizative, përfshirë edhe ato që lidhen me arritjen e rezultateve të caktuara;

c) masat e nevojshme për arritjen e synimeve dhe objektivave, si dhe veprimtaritë, aftësitë, teknologjitë, kapitalin, burimet njerëzore, informacionin dhe burimet e tjera të nevojshme për arritjen e synimeve dhe objektivave;

d) identifikimin e faktorëve kyç, të jashtëm për njësinë organizative dhe përtej kontrollit të saj, që mund të ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në arritjen e synimeve dhe objektivave; dhe

e) përshkrimin e metodave vlerësuese për përcaktimin dhe rishikimin e synimeve dhe objektivave, së bashku me një skedul të këtyre vlerësimeve.

2. Plani strategjik mbulon një periudhë jo më pak se 2 vjet, duke filluar nga data në të cilën miratohet, dhe mund të rishikohet e të përditësohet, të paktën, një herë në vit.
3. Propozimet e njësive organizative për planet e punës, sipas nenit 6, janë në përputhje me planin strategjik.
4. Gjatë hartimit të propozimeve për planin strategjik, çdo njësi organizative konsultohet me Komitetin dhe kërkon e reflekton pikëpamjet e sugjerimet e njësive organizative të interesuara.

Neni 6
Planet e punës

1. Brenda muajit janar të çdo viti, çdo njësi organizative i paraqet Komitetit një plan vjetor pune, i cili:

a) vendos objektivat për t'u arritur nga njësia organizative, të shprehur në një mënyrë objektive, sasiore e të matshme, me përjashtim të rasteve kur lejohet një formë alternative në bazë të pikës 2 të këtij neni;
b) përshkruan veprimtaritë, aftësitë, teknologjinë, burimet njerëzore, kapitalin, informacionin ose burimet e tjera të nevojshme për realizimin e objektivave;
c) përcakton tregues performance për t'u përdorur në matjen dhe vlerësimin e produktit, shërbimit e rezultatit të çdo veprimtarie;
d) ofron një bazë për krahasimin e rezultateve të arritura me objektivat e vendosur; dhe
e) përshkruan mjetet për t'u përdorur për verifikimin dhe konfirmimin e përfundimeve të nxjerra.

2. Komiteti sugjeron përdorimin e një forme alternative nëse, pas konsultimit me njësinë organizative përkatëse, çmon se synimet e performancës për një veprimtari të veçantë, nuk mund të shprehen në një mënyrë objektive, sasiore dhe të matshme. Kjo formë alternative:

a) përshkruan kriteret për përcaktimin e efektshmërisë dhe suksesit të veprimtarisë;
b) shprehet me saktësi të mjaftueshme dhe në terma të tillë që lejojnë një përcaktim të saktë dhe të pavarur të performancës së veprimtarisë; dhe
c) shpjegon shkaqet e pamundësisë së shprehjes së synimeve në një mënyrë objektive, sasiore dhe të matshme.

3. Çdo njësi organizative mund të bashkojë, ndajë dhe të konsolidojë veprimtaritë, me kusht që një veprim i tillë të mos përjashtojë ose minimizojë rëndësinë e tyre.

Neni 7
Analizat e punës

1. Njësitë organizative i raportojnë rregullisht Komitetit, për performancën e realizuar kundrejt synimeve dhe objektivave të vendosura në planin strategjik dhe në planin e punës për periudhën e vlerësimit.
2. Çdo analizë përmban treguesit e performancës të shprehura në planin e punës së njësisë organizative, në bazë të nenit 6, së bashku me performancën e realizuar kundrejt objektivave.

3. Kur synimet e performancës janë specifikuar në një formë alternative, sipas nenit 6, rezultatet e arritura përshkruhen sipas këtyre specifikimeve, duke përcaktuar, veçanërisht, efektivitetin dhe suksesin e veprimtarive.
4. Çdo analizë:

a) shqyrton suksesin në përmbushjen e objektivave dhe synimeve për periudhën e vlerësimit;
b) vlerëson veprimtaritë e parashikuara për periudhën e ardhshme të vlerësimit kundrejt progresit të arritur në përmbushjen e synimeve dhe objektivave të periudhës së mbuluar në analizë;
c) përshkruan dhe shpjegon, kur një synim ose objektiv nuk është arritur (përfshirë edhe rastet kur është zgjedhur një formë alternative):
   i) shkaqet e mosarritjes së synimit ose objektivit,
   ii) planet dhe afatet për arritjen e tyre,
   iii) nëse arritja e synimit ose objektivit është e pamundur ose jo-praktike, shpjegohen shkaqet e pamundësisë si dhe veprimet që do të merren, dhe
   d) përmbledh përfundimet e vlerësimeve të kryera gjatë periudhës së vlerësimit të mbuluar në raport.

5. Analizat e punës përbëjnë bazën kryesore të vlerësimit të rezultateve në punë të punonjësve dhe shoqërojnë në çdo rast praktikën e vlerësimit.

Neni 8
Përcaktimi i objektivave

1. Eprori i drejtpërdrejtë, në bashkëpunim me punonjësin, përcakton objektivat për t'u arritur gjatë periudhës së vlerësimit, përkundrejt të cilëve maten rezultatet individuale në punë.
2. Objektivat përcaktojnë rezultatet në punë për një vend të caktuar pune, duke reflektuar prioritetet e njësisë organizative dhe të Bankës për periudhën në fjalë. Objektivat duhet të jenë:

a) specifike – të qarta, të drejtpërdrejta, të kuptueshme dhe pa shumë kuptime;
b) të matshme – nga ana sasiore, cilësore, kohore dhe financiare;
c) të arritshme nga punonjësi i angazhuar dhe kompetent. Eprori i drejtpërdrejtë mban parasysh pengesat që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave, duke përfshirë mungesën e burimeve, përvojës, trajnimeve si dhe faktorët e jashtëm;
d) të përshtatshme – të përputhen me objektivat e përcaktuara në planin strategjik dhe në planin e punës së njësisë organizative; dhe
e) kohore – të arritshme brenda një periudhe kohe të caktuar.

3. Eprori i drejtpërdrejtë përcakton objektivat që synohen të arrihen

nga punonjësi, afatin dhe mënyrën e realizimit.

4. Eprori i drejtpërdrejtë kujdeset që objektivat personale të punonjësit:

a) të jenë pjesë integrale e punës së punonjësit;
b) të përshkruajnë saktësisht atë që pritet prej punonjësit dhe të përqendrohen në rezultatin ose produktin përfundimtar;
c) të përcaktojnë mënyrën si demonstrohet arritja e objektivave nga ana sasiore dhe cilësore;
d) të marrin parasysh përvojën e punonjësit në atë vend pune, burimet në kontrollin e tij dhe faktorët që nuk mund të kontrollojë ose të ndikojë; dhe
e) të reflektojnë nevojën e punonjësit për trajnime.

KREU III
VLERËSIMI I REZULTATEVE

Neni 9
Rolet dhe përgjegjësitë

Vlerësimi i rezultateve individuale në punë përcakton rezultatet e arritura përkundrejt objektivave dhe synimeve të vendosura. Rezultatet individuale në punë të çdo punonjësi vlerësohen nga eprori i drejtpërdrejtë dhe nënshkruhen nga drejtuesi i njësisë organizative.

Neni 10
Periudha e vlerësimit

Gjatë vitit, punonjësit u nënshtrohen dy vlerësimeve, secili prej të cilëve mbulon një periudhë gjashtëmujore pune.

Neni 11
Eprori i drejtpërdrejtë

1. Eprori i drejtpërdrejtë siguron se ka të dhëna të mjaftueshme për të dhënë një gjykim objektiv për vlerësimin e rezultateve individuale në punë të punonjësve në varësi të tij.
2. Në fund të periudhës së vlerësimit, eprori i drejtpërdrejtë diskuton me punonjësin performancën e shfaqur dhe zhvillimin e saj në të ardhmen. Ky takim mbahet në fund të gjashtëmujorit të vlerësimit, përpara përfundimit të raportit të performancës. Diskutimi mbështetet, në fakte dhe në prova.
3. Eprori i drejtpërdrejtë dhe punonjësi adresojnë performancën në lidhje me:

a) realizimin e objektivave të punës; dhe
b) aftësitë dhe njohuritë e zhvilluara e të shfaqura.

4. Diskutimi i performancës ofron një mundësi formale për të:

a) diskutuar veprimtaritë që kanë shkuar mirë dhe ato që kanë shkuar jo mirë dhe për të përcaktuar arsyet;
b) diskutuar planet për të ardhmen në dritën e planit të punës së njësisë organizative dhe strategjive të Bankës;
c) konsideruar mënyra për përmirësimin e performancës në të ardhmen dhe veprimet mbështetëse në këtë drejtim; dhe
d) rënë dakord mbi veprimet.

5. Në përfundim të takimit, eprori i drejtpërdrejtë:

a) përmbledh vlerësimin e tij për arritjet përkundrejt objektivave, kontributin e përgjithshëm gjatë gjithë periudhës së vlerësimit dhe zhvillimin e aftësive dhe cilësive drejtuese. Vlerësimi i arritjeve përmbledh mënyrën si janë realizuar objektivat dhe reflekton evidencën e ofruar nga vet punonjësi;
b) në rastet kur mbarëvajtja në punë është e pakënaqshme eprori i drejtpërdrejtë ndjek procedurën e veçantë sipas nenit 19.

6. Eprori i drejtpërdrejtë i komunikon punonjësit propozimin lidhur me shpërblimet e shtesat mbi pagë, duke i shpjeguar arsyet mbi të cilat mbështeten, për sa i përket arritjes së objektivave dhe aftësive të shfaqura.

Neni 12
Vetëvlerësimi

1. Vetëvlerësimi ka për qëllim arritjen e një vlerësimi të përbashkët të performancës dhe një plani zhvillimi, si dhe motivimin dhe zhvillimin e punonjësit në të ardhmen. Para takimit, eprori i drejtpërdrejtë i jep punonjësit strukturën e vetëvlerësimit, duke synuar evidentimin e:

a) aspekteve të punës ku është punuar më mirë dhe arritjeve kryesore gjatë periudhës së vlerësimit;
b) pengesave dhe vështirësive në arritjen e objektivave, arsyet dhe masat për shmangien e tyre në të ardhmen;
c) përmirësimeve të nevojshme të performancës, udhëzimet dhe ndihma që mund të jepet nga eprori i drejtpërdrejtë; dhe
d) nevojave për trajnim.

2. Gjatë takimit, sipas nenit 11, eprori i drejtpërdrejtë analizon dhe diskuton me punonjësin vetëvlerësimin, duke synuar evidentimin dhe zgjidhjen e problemeve kryesore që janë ndeshur nga punonjësi dhe duke e inkurajuar atë të reflektojë rreth tyre.
3. Eprori i drejtpërdrejtë i jep punonjësit udhëzimet e nevojshme për kryerjen me sukses të vetëvlerësimit. Për këtë qëllim, DBNJ mbështet punonjësit dhe eprorët e drejtpërdrejtë me informacion,

udhëzime dhe sqarime për kryerjen e procesit, sa herë që është e nevojshme.

4. Vetëvlerësimi nuk mund të përdoret si bazë për marrjen e vendimeve për shpërblimet, shtesat mbi pagë, ngritjet në detyrë dhe masat disiplinore.

Neni 13
Drejtuesi i njësisë organizative

1. Drejtuesi i njësisë organizative garanton që vlerësimi i punonjësve është në përputhje me këtë rregullore dhe kontrollon vlerësimet e eprorit të drejtpërdrejtë. Drejtuesi nënshkruan vlerësimin për të konfirmuar se rregullat janë zbatuar drejt dhe që bie dakord me vlerësimin.
2. Në konsultim me eprorin e drejtpërdrejtë, drejtuesi i njësisë organizative mund të ndryshojë vlerësimet nëse çmon se këto nuk janë në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë rregullore. Në rast mosmarrëveshjeje, çdo ndryshim i bërë mbetet në fuqi, me kusht që drejtuesi të japë arsyet e veta.
3. Gjatë gjithë periudhës së vlerësimit, drejtuesi i njësisë organizative mban kontakte të rregullta me eprorin e drejtpërdrejtë dhe me punonjësit, për të siguruar që sistemi i vlerësimit funksionon me efikasitet dhe pa probleme.
4. Drejtuesi i njësisë organizative siguron që punonjësit të vlerësohen në mënyrë objektive dhe që eprorët e drejtpërdrejtë kanë njohuri të plota të sistemit dhe kanë identifikuar çdo nevojë për trajnim.
5. Drejtuesi i njësisë organizative garanton një kulturë të lartë performance që siguron:

a) komunikimin e qartë të misionit, objektivave e synimeve strategjike dhe operacionale të Bankës, njësisë organizative dhe punonjësve; dhe
b) informimin e të gjithë punonjësve për progresin drejt arritjes së objektivave dhe masave të nevojshme për përmirësimin e performancës.

Neni 14
Vlerësimi i performancës dhe rezultateve në punë

1. Guvernatori, në bashkëpunim me Administratorin përkatës, vlerëson performancën dhe rezultatet në punë të nivelit të lartë të drejtimit.
2. Drejtuesi i njësisë organizative, në bashkëpunim me eprorin e drejtpërdrejtë, vlerëson performancën dhe rezultatet në punë të punonjësve të:

a) nivelit të ulët të drejtimit;
b) nivelit të shërbimit profesional; dhe
c) nivelit të shërbimit të përgjithshëm.

3. Formularët e vlerësimit të punonjësve miratohen me urdhër të veçantë të Guvernatorit.

Neni 15
Procedura e vlerësimit

1. Formularët e vlerësimit mbulojnë një periudhë gjashtëmujore vlerësimi performance dhe rezultatesh në punë.
2. Jo më vonë se tre ditë pas përfundimit të periudhës së vlerësimit, drejtuesi i njësisë organizative dorëzon në DBNJ praktikën e vlerësimit.
3. DBNJ ruan praktikën e vlerësimit, të paktën, tre vjet pas dorëzimit. Rezultatet e vlerësimit futen në dosjen personale të punonjësit.

Neni 16
Klasifikimi i rezultateve në punë

1. Në përfundim të vlerësimit, eprori i drejtpërdrejtë i komunikon punonjësit klasifikimin e rezultateve të tij në punë, i cili mbështetet në vlerësimin e performancës për periudhën e vlerësimit. Klasifikimi tregon nivelin e rezultateve në punë dhe sjelljes së shfaqur nga punonjësi.
2. Klasifikimi i rezultateve në punë përfshin këto nivele:

a) niveli 1: jo-mjaftueshëm: rezultatet nuk arrijnë minimumin e nevojshëm të objektivave dhe kërkesave të vendit të punës. Punonjësi nuk tregon angazhim për përmirësimin e tyre dhe shfaq mungesë aftësish për të cilat është diskutuar gjatë shqyrtimit të performancës;
b) niveli 2: mjaftueshëm: rezultatet individuale arrijnë minimumin e nevojshëm të objektivave e kërkesave të vendit të punës dhe nevojiten përmirësime të konsiderueshme;
c) niveli 3: mirë: rezultatet individuale arrijnë nivelin mesatar të objektivave dhe kërkesave të vendit të punës;
d) niveli 4: shumë mirë: rezultatet individuale arrijnë të gjitha objektivat dhe kërkesat e vendit të punës; dhe
e) niveli 5: shkëlqyeshëm: rezultatet individuale janë dukshëm mbi nivelin e pritshëm dhe arritja në punë ka tejkaluar atë që është kërkuar.

3. Niveli i klasifikimit përbën bazën për përcaktimin e shpërblimit dhe shtesave mbi pagë. Punonjësit e klasifikuar sipas nivelit 1, të përcaktuar në germën "a" të pikës 2 të këtij neni, nuk përfitojnë shpërblim dhe as shtesë mbi pagë.
4. DBNJ udhëzon drejtuesit e njësive organizative për mënyrën e plotësimit të formularëve dhe monitoron shpërndarjen e tyre.

Neni 17
Shpërblimi

1. Punonjësi përfiton shpërblim suplementar për rezultatet individuale në punë, mbështetur mbi rezultatet e vlerësimit. Shpërblimi jepet në formën e një pagese të vetme, të shprehur në përqindje ndaj pagës mujore, e cila nuk konsiderohet pjesë përbërëse e pagës bazë.
2. Shpërblimi i marrë prej punonjësit për periudhën gjashtëmujore të vlerësimit nuk mund të kalojë masën një pagë mujore. Gjatë një viti kalendarik, shpërblimet suplementare për rezultatet individuale në punë nuk mund të kalojnë shumën e dy pagave mujore.
3. Shpërblimi akordohet, në çdo rast, për periudhën e vlerësimit. Për efekt të dhënies së shpërblimit konsiderohen ditë pune edhe ditët e pushimit vjetor të pagueshëm. Shpërblimi akordohet edhe në rastet kur punonjësi:

a) është trajtuar me paaftësi të përkohshme, për një kohë jo më të gjatë se gjysma e kohës së periudhës së vlerësimit, por në çdo rast në raport me faktin e paraqitjes në punë në Bankë gjatë kësaj periudhe;
b) është pezulluar nga puna, për një kohë jo më të gjatë se tre muaj gjatë periudhës së vlerësimit;
c) është në marrëdhënie pune me kohëzgjatje të caktuar, nëse në datën e dhënies së këtyre shpërblimeve ka kryer jo më pak se një vit punë; dhe
d) është në marrëdhënie pune me kohë të pjesshme. Shpërblimi akordohet përpjestimisht me kohën e punës për të cilën, sipas kontratës individuale të punës, punonjësi është në dispozicion të Bankës.

4. Propozimet për shpërblim i paraqiten Komitetit nga drejtuesit e njësive organizative dhe drejtuesit e degëve të Bankës, duke argumentuar, në çdo rast, shkakun e dhënies së shpërblimit. Koha dhe masa e shpërblimit përcaktohen nga Guvernatori, me propozim të Komitetit.
5. Përjashtohen nga e drejta e përfitimit të shpërblimit të mësipërm punonjësit:

a) ndaj të cilëve është marrë një masë disiplinore, e cila nuk është shlyer apo hequr përpara propozimit për shpërblim;
b) të emëruar për herë të parë në Bankë gjatë kohës së vazhdimit të periudhës së provës;
c) të cilët largohen nga puna si rezultat i masave disiplinore; dhe
d) të cilëve u përfundon marrëdhënia e punës me kohë të caktuar me Bankën e Shqipërisë.

Neni 18
Shtesa mbi pagë

1. Punonjësit me arsim të lartë të nivelit të shërbimit profesional dhe punonjësit e nivelit të ulët drejtues, përfitojnë një shtesë mbi pagë, e cila llogaritet në përqindje ndaj pagës bazë mujore dhe nuk mund të kalojë 20 për qind të saj.
2. Vendimi për masën e përfitimit të shtesës mbi pagë mbështetet në rezultatet individuale të punës.
3. Në vlerësimin e punonjësve të nivelit të ulët të drejtimit, mbahet parasysh edhe vlerësimi që këta punonjës u bëjnë punonjësve në varësi të tyre.
4. Drejtuesi i njësisë organizative dërgon në DBNJ vendimin për shtesën mbi pagë të çdo punonjësi në varësi të tij, brenda tre ditëve nga përfundimi i periudhës së vlerësimit. Ky dokument përbën pjesë të praktikës së vlerësimit dhe ruhet në DBNJ, të paktën, tre vjet pas periudhës së vlerësimit.

Neni 19
Veprimet e mbështetura në performancën e papranueshme

1. Në përputhje me dispozitat e këtij kreu, drejtuesi i njësisë organizative mund të propozojë uljen në detyrë ose largimin nga puna të një punonjësi për performancë jo të mjaftueshme gjatë dy vlerësimeve të njëpasnjëshme.
2. Në rastet e parashikuara nga pika 1 e këtij neni, ndiqen procedurat dhe kriteret e përcaktuara në nenin 64 të rregullores "Për marrëdhëniet e punës të personelit të Bankës së Shqipërisë".
3. Kjo dispozitë nuk zbatohet ndaj:

a) punonjësit të emëruar me afat të caktuar; dhe
b) punonjësit të emëruar në një vend të ri pune, nëse në momentin e vlerësimit, ka punuar më pak se 3 muaj.

Neni 20
Departamenti i Burimeve Njerëzore

1. DBNJ është përgjegjës për administrimin teknik të procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, përfshirë shpërndarjen, mbledhjen dhe ruajtjen e formularëve në dosjet personale të punonjësve.
2. DBNJ u jep drejtuesve të njësive organizative të tjera këshilla teknike për funksionimin korrekt të procesit dhe për mënyrën e adresimit të problemeve të veçanta.
3. Në zbatim të rolit të tij, DBNJ:

a) evidenton punonjësit me performancë më të lartë për zhvillim dhe planifikim karriere;
b) evidenton punonjësit me performancë me të ulët, për të vendosur,

së bashku me drejtuesit e njësive organizative, veprimet që duhen ndërmarrë;

c) evidenton kategorizimet, me qëllim marrjen e vendimeve për shpërblimet dhe shtesat mbi pagë sipas performancës;
d) përcakton nevojat e punonjësve për trajnim;
e) monitoron ecurinë e eprorëve të drejtpërdrejtë në procesin e menaxhimit të performancës në punë; dhe
f) zhvillon anketime të rregullta lidhur me reagimet e punonjësve ndaj menaxhimit të performancës.

4. DBNJ informon Komitetin për çdo problem që mund të lindë gjatë procesit të vlerësimit të rezultateve në punë dhe i ofron të dhënat statistikore që i kërkohen.

Neni 21
Komiteti i Vlerësimit të Performancës

1. Komiteti kujdeset për mbarëvajtjen e procesit të vlerësimit dhe aprovon rekomandimet e drejtuesve të njësive organizative për shpërblimet dhe shtesat mbi pagë të punonjësve. Për këtë qëllim, Komiteti:

a) diskuton me drejtuesit e njësive organizative për nivelin e vlerësimeve për t'u arritur gjatë një periudhe vlerësimi, duke zhvilluar, të paktën, një takim gjatë periudhës së vlerësimit për të diskutuar vlerësimet që synohen të bëhen, përpara vlerësimit përfundimtar;
b) kontrollon nivelin e vlerësimeve të rezultateve në punë të çdo njësie organizative në raport me realizimin e objektivave strategjikë dhe operacionalë;
c) shqyrton rekomandimet lidhur me shpërblimet dhe shtesat mbi pagë, për të siguruar mungesën e diskriminimit, konsistencë dhe drejtësi;
d) i propozon Guvernatorit shpërblimet dhe shtesat mbi pagë të punonjësve; dhe
e) shqyrton ankimet e punonjësve për vlerësimet, sipas nenit 22 të kësaj rregulloreje.

2. Gjatë ushtrimit të detyrave të mësipërme, Komiteti shqyrton veçanërisht cilësinë e vlerësimeve të drejtuesve të njësive organizative dhe mbështetjen e tyre mbi fakte dhe prova. Komiteti mund t'u kërkojë drejtuesve të njësive organizative informacione shtesë.
3. Përgjegjësia për parregullsi apo për gabime të konstatuara nga Komiteti, i përket drejtuesit të njësisë organizative që ka bërë vlerësimin.
4. Komiteti përgatit një raport mbi ecurinë dhe rezultatet e arritura në përfundim të procesit të vlerësimit të rezultateve në punë dhe e paraqet brenda pesë ditëve tek Guvernatori.

5. Përbërja e Komitetit përcaktohet me urdhër të veçantë të Guvernatorit.
6. Afati i veprimtarisë së Komitetit është i pakufizuar.

Neni 22
Ankimet

1. Mosmarrëveshjet e punonjësit me eprorin e drejtpërdrejtë dhe drejtuesin e njësisë organizative, lidhur me vlerësimin e rezultateve individuale në punë, zgjidhen me konsensus.
2. Kur nuk është e mundur të arrihet konsensusi, punonjësi mund të ankohet, me shkrim, kundër vlerësimit përpara Komitetit, vetëm në rastet kur:

a) nuk janë përfshirë në vlerësim, informacione ose fakte të caktuara gjatë diskutimit të performancës ose moderimit;
b) janë shkelur dispozitat e kësaj rregulloreje, duke ndikuar në vlerësimin e rezultateve individuale në punë; dhe
c) vlerësimi është mbështetur në motive të pandashme nga personaliteti i punonjësit, por që nuk kanë lidhje legjitime me marrëdhëniet e punës. Konsiderohen si motive të tilla, raca, ngjyra, seksi, mosha, gjendja civile, detyrimet familjare, shtatzënia, besimi fetar, bindjet politike, kombësia, gjendja shoqërore.

3. Ankimi i paraqitet Komitetit brenda 5 ditëve nga marrja dijeni për vlerësimin dhe përmban, në çdo rast, shkaqet, të cilat nuk mund të lidhen me mosrënien dakord me kontributin individual në raport me atë të kolegëve.
4. Komisioni shqyrton ankimin dhe kur është e nevojshme, kërkon mendimin e drejtuesit të njësisë organizative lidhur me pretendimet e ngritura nga punonjësi. Brenda 2 (dy) javësh nga dita e depozitimit të ankimit, Komisioni vendos:

a) rrëzimin e pretendimeve të paraqitura në ankim; ose
b) pranimin e ankimit dhe dërgimin për rivlerësim pranë njësisë organizative përkatëse. Njësia organizative, në rivlerësim, detyrohet t'i përmbahet vendimit të Komitetit.

5. Vendimi i njoftohet punonjësit, drejtuesit të njësisë organizative dhe DBNJ për ta përfshirë në dosjen personale të punonjësit. Vendimet e Komitetit janë të detyrueshme për njësitë organizative dhe përfshihen në raportin për Guvernatorin, përcaktuar në pikën 4, të nenit 21 të kësaj rregulloreje.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 23
Shfuqizime

1. Rregullorja "Mbi kriteret e vlerësimit të rezultateve në punë të punonjësve në Bankën e Shqipërisë", miratuar me vendimin nr. 109, datë 24.12.2003 të Këshillit Mbikëqyrës, shfuqizohet.
2. Të gjitha dispozitat e akteve nënligjore të Bankës së Shqipërisë që bien në kundërshtim me këtë rregullore, shfuqizohen.

Neni 24
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

ARDIAN FULLANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr.15, datë 10.03.2010

PËR
MIRATIMIN E "KONTRATËS - TIP PËR RIBLERJEN E TITUJVE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "c", të nenit 53, paragrafi i fundit i ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë "Kontratën - Tip për riblerjen e titujve" sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të autorizojë Drejtorin e Departamentit të Operacioneve Monetare për nënshkrimin e Kontratës – Tip për riblerjen e titujve.
3. Ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, Departamenti i Kontabilitetit dhe Financës në Bankën e Shqipërisë, si dhe bankat dhe degët e bankave të huaja për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare në Bankën e Shqipërisë për dërgimin e këtij vendimi bankave dhe degëve të bankave të huaja.
5. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit në Bankën e Shqipërisë për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr.13, datë 09.02.2005 "Për miratimin e kontratës - tip për marrëveshjet e riblerjeve dhe të anasjellta të riblerjeve të letrave me vlerë".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI	KRYETARI
YLLI MEMISHA	ARDIAN FULLANI

KONTRATA TIP PËR RIBLERJEN E TITUJVE

Palët:

Banka e Shqipërisë (si më poshtë për thjeshtësi: "Banka"), me adresë: "Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë, e përfaqësuar ligjërisht në këtë kontratë nga zoti _____, Drejtor i Departamentit të Operacioneve Monetare.

dhe

Banka/Dega e Bankës _____ me adresë të selisë _____, përfaqësuar ligjërisht në këtë kontratë nga zoti _____.

Bien dakord të lidhin këtë kontratë sipas kushteve të mëposhtme:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Baza ligjore

Kjo kontratë lidhet në bazë dhe për zbatim të akteve të mëposhtme:

a) ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar;
b) ligjit nr. 9974, datë 28.07.2008 "Për kontratën e riblerjes së titujve";
c) Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë;
d) rregullores "Mbi garancitë në operacionet krediturese të Bankës së Shqipërisë", miratuar me vendimin nr.107, datë 24.12.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë;
e) rregullores "Mbi marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes", miratuar me vendimin nr. 93, datë 13.12.2006 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë të ndryshuar;
f) rregullores "Për transaksionet me titujt ndërmjet bankave dhe funksionimin e sistemit të regjistrimit të titujve", miratuar me vendimin nr.61, datë 29.07.2009 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë; dhe
g) akteve të tjera nënligjore të Bankës.

Neni 2
Qëllimi

1. Palët nëpërmjet kësaj kontrate tip kanë për qëllim të rregullojnë transaksionet që ato lidhin për shitjen/blerjen e titujve me të drejtë riblerjeje/rishitjeje, të kryera nga Banka me qëllim

tërheqjen/injektimin e përkohshëm të likuiditeteve nga/në sistemin bankar.

Neni 3
Objekti

1. Objekti i kësaj kontrate është përcaktimi i kushteve, rregullave dhe modaliteteve të nevojshme për realizimin e transaksioneve të riblerjes së titujve ndërmjet palëve.
2. Nëpërmjet transaksioneve të lidhura në bazë të kësaj kontrate, njëra palë (Riblerësi) bie dakord t'i shesë palës tjetër (Rishitësit) tituj, përkundrejt pagimit të çmimit të blerjes nga Rishitësi tek Riblerësi, me një marrëveshje të njëkohshme që Rishitësi t'i shesë Riblerësit të njëjtët tituj ose sasi titujsh, në një datë të ardhshme të rënë dakord paraprakisht, përkundrejt pagimit të çmimit të riblerjes nga Riblerësi tek Rishitësi.
3. Çdo transaksion i riblerjes së titujve i kryer në mënyrë individuale ose mbi baza të qëndrueshme (transaksione të shumëfishta dhe/ose që përsëriten në kohë) ndërmjet palëve rregullohet në përputhje me përcaktimet e kësaj kontrate.

Neni 4
Parimi që udhëheq kontratën

1. Transaksionet e lidhura në bazë të kësaj kontrate janë pjesë e një marrëdhënieje të vetme kontraktore ndërmjet palëve dhe në përputhje me këtë parim:

a) çdo detyrim i lidhur me një transaksion të vetëm merret përsipër nga njëra palë dhe ekzekutohet, duke marrë në konsideratë detyrimet e marra përsipër për t'u ekzekutuar nga pala tjetër për të gjitha transaksionet e kontratës; dhe
b) mosekzekutimi i një detyrimi nga njëra palë lidhur me një transaksion të vetëm konsiderohet si mospërmbushje e detyrimeve të kontratës.

2. Parimi i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni është themelor për vlerësimin e rreziqeve ligjore dhe operacionale që rrjedhin nga zbatimi i kontratës.

Neni 5
Përkufizime

Në zbatim të kësaj kontrate, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) "Çmimi i blerjes" nënkupton çmimin që Rishitësi i paguan Riblerësit për titullin që Riblerësi do t'i shesë Rishitësit;
b) "Çmimi i riblerjes" nënkupton shumën e çmimit të blerjes me çmimin diferencial;

c) "Çmim diferencial" nënkupton për çdo transaksion shumën agregate të përfituar nga aplikimi i normës së interesit të rënë dakord për çdo transaksion dhe të shprehur si një përqindje vjetore ndaj çmimit të blerjes, për numrin faktik të ditëve gjatë periudhës nga (duke e përfshirë) data e blerjes deri (por duke përjashtuar) datën e riblerjes, mbi një bazë prej 360 ose 365 ditësh në përputhje me praktikat e tregut ose mbi çdo bazë tjetër të përcaktuar nga Banka dhe të komunikuar palës tjetër;

d) "Dorëzimi kundrejt pagesës" - është parimi i komunikimit, midis sistemit të shlyerjes së titujve dhe sistemit të shlyerjes së cash-it, i cili nënkupton që në një transaksion shitblerjeje të titujve, transferimi i pronësisë së titujve, ndodh vetëm nëse pagesa cash është përfunduar paraprakisht;

e) "Kolateral" – titull i vendosur si garanci;

f) "Akt në lidhje me paaftësinë paguese" nënkupton rastet e mëposhtme, kur njëra nga palët ose mëma e saj në rastin e filialit ose degës së bankës së huaj:

   i. ka kryer një transferim të përgjithshëm të të drejtave në përfitim të kreditorëve, ose ka hyrë në një marrëveshjeje riorganizimi apo çfarëdolloj marrëveshjeje tjetër me kreditorët,

   ii. ka pranuar me shkrim se nuk është në gjendje të paguajë detyrimet e saj me afrimin e maturimit të tyre,

   iii. është duke kërkuar, lejuar, ose është e përfshirë me veprime konkludente në caktimin/emërimin e ndonjë administratori, kujdestari, likuidatori ose çfarëdolloj nëpunësi apo zyrtari tjetër analog apo të ngjashëm të tij apo të pasurive të tij,

   iv. është ose ka paraqitur apo depozituar ndonjë lutje dhe/ose kërkesë përpara ndonjë gjykate ose subjekti që mund të ketë të bëjë me falimentimin, paaftësinë paguese, likuidimin, mbylljen e saj, ose është duke kërkuar ndonjë riorganizim, marrëveshje, ristrukturim, rirregullim, administrim, likuidim, shpërbërje ose lehtësim të ngjashëm në bazë të legjislacionit në fuqi ose të së ardhmes, me kusht që një lutje dhe/ose kërkesë e tillë të mos jetë pezulluar ose rrëzuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga depozitimi,

   v. është emëruar ndonjë administrator, kujdestar, likuidator ose çfarëdolloj nëpunësi apo zyrtari tjetër analog apo i ngjashëm i tij apo i pasurive të tij,

   vi. është thirrur ndonjë mbledhje e kreditorëve të tij për qëllime të ndërmarrjes së ndonjë akti apo procedure që mund të ketë të bëjë me falimentimin, paaftësinë paguese, likuidimin, mbylljen e saj, ose për qëllime të lidhjes së një marrëveshjeje riorganizimi apo çfarëdolloj marrëveshjeje tjetër me kreditorët,

   vii. dështon në përmbushjen e detyrimeve që ngrihen nga pjesëmarrja e saj në operacionet me Bankën,

   viii. nëse pjesëmarrja e saj në sistemet e pagesave është pezulluar, edhe nëse pezullimi është i përkohshëm,

ix. nëse kushtet financiare të saj, sipas gjykimit të Bankës mund të çojnë në paaftësi paguese të saj, dhe
x. nëse raporton ose publikon informacion financiar të rremë ose të pasaktë sipas gjykimit të Bankës.

g) "netting"- nënkupton se me verifikimin e rrethanave të përcaktuara në shkronjën "f" më sipër, pala tjetër ka të drejtë të tërhiqet nga kontrata dhe të vërë në zbatim të detyrueshëm procedurën sipas të cilës:

I. bëhet e detyrueshme pagesa/ shlyerja e të gjitha detyrimeve të kontraktuara në bazë të transaksioneve/kontratave individuale pjesë të kësaj kontrate, përfshirë dhe ato të pamaturuara.
II. të gjitha transaksionet e papërfunduara të kësaj kontrate konsiderohen të mbaruara, dhe
III. vlera e të gjitha detyrimeve ndërmjet palëve të përllogaritura sipas pikave "I" dhe "II" të kësaj shkronje, si detyrimet monetare (të pagesave) ashtu dhe ato për transferimin dhe ritransferimin e titujve (përfshi dhe kolateralin) kompensohen dhe sigurohet ekzekutimi i detyrueshëm i diferencës së vetme neto të rezultuar nga njëra palë tek tjetra.

Neni 6
Legjislacioni që rregullon kontratën dhe interpretimi

1. Çdo transaksion i kontratës si dhe vetë kontrata në tërësi qeverisen nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë.
2. Çdo formulim i kontratës që mund të sjellë paqartësi, interpretohet në përputhje me qëllimet, frymën dhe përmbajtjen e Ligjit për kontratën e riblerjes së titujve dhe akteve rregullative të Bankës.
3. Për të gjitha çështjet që nuk parashikohen shprehimisht në këtë kontratë, zbatohen dispozitat e Ligjit për kontratën e riblerjes së titujve dhe akteve rregullative të Bankës.

Neni 7
Titujt

Titujt që janë objekt i transaksioneve të riblerjes përcaktohen në rregulloren "Mbi marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes".

Neni 8
Vlerësimi i titujve

1. Vetëm në transaksionet për të cilat Banka është në rolin e Rishitësit, titujt vlerësohen sipas rregullores "Mbi garancitë në operacionet kredituese të Bankës së Shqipërisë".
2. Për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve që lindin ndaj Bankës nga transaksionet e kësaj kontrate, kur kjo e fundit është në rolin e Rishitësit, Riblerësi ka detyrimin të transferojë tituj të tjerë si kolateral, sipas përcaktimeve të rregullores "Mbi garancitë në operacionet kredituese të Bankës së Shqipërisë."

Neni 9
Mjetet e komunikimit për lidhjen e transaksioneve

Për çdo transaksion që kryhet në bazë të kësaj kontrate, palët mund të përdorin si mjete komunikimi SWIFT, REUTERS ose shkresë zyrtare.

Neni 10
Dorëzimet dhe pagesat

1. Në rastin e blerjes, në datën e shlyerjes së rënë dakord për blerjen e titujve për çdo transaksion, Riblerësi transferon tek Rishitësi pronësinë e titujve të shitur në atë transaksion përkundrejt pagesës së çmimit të blerjes, në përputhje me parimin e dorëzimit kundrejt pagesës.
2. Në rastin e riblerjes, në datën e shlyerjes së rënë dakord për riblerjen e titujve, Rishitësi transferon tek Riblerësi pronësinë e të njëjtit lloj dhe sasie titujsh të shitur sipas pikës 1 të këtij neni, përkundrejt pagesës të çmimit të riblerjes në përputhje me parimin e dorëzimit kundrejt pagesës.
3. Rastet e dorëzimit me vonesë të titujve trajtohen në përputhje me rregulloren "Për transaksionet me titujt ndërmjet bankave dhe funksionimin e sistemit të regjistrimit të titujve".

Neni 10
Zëvendësimi i titujve

1. Riblerësi ka të drejtë që me shpenzimet e tij dhe me pëlqimin e Rishitësit, të zëvendësojë titujt me tituj të tjerë, me kusht që këta të fundit, në momentin e rënies dakord për zëvendësimin, pas vlerësimit sipas nenit 8 të kontratës, të kenë vlerë jo më të vogël se vlera e titujve fillestarë në ditën kur është bërë transaksioni.
2. Zëvendësimi kryhet nëpërmjet transferimit të njëkohshëm të pronësisë së titujve të rinj në këmbim të transferimit të pronësisë së titujve që do të zëvendësohen dhe nuk përbën një kontratë të re ndërmjet palëve.
3. Çdo komunikim ndërmjet palëve për qëllimet e këtij neni kryhet me SWIFT,REUTERS ose shkresë zyrtare.

Neni 11
Valuta kontraktore

Çdo transaksion që kryhet në bazë dhe për zbatim të kësaj kontrate, ekzekutohet në Lekë (ALL).

Neni 12
Të ardhurat monetare për titujt dhe pagesa e tyre

1. Rishitësi i transferon Riblerësit një shumë të barabartë me shumën e të ardhurave monetare që përfitohen nga emetuesi për titujt e

blerë ose titujt e vendosur si kolateral në transaksionet e kryera në zbatim të kësaj kontrate.

2. Rishitësi paguan të ardhurat në të njëjtën ditë që ato paguhen nga emetuesi i titullit.

Neni 13
Zgjidhja e kontratës

Kjo kontratë zgjidhet në rastet e mëposhtme, në të cilat veprohet përkatësisht si vijon:

a) në rastet kur vërtetohen rrethanat që kanë lidhje me ekzistencën e ndonjë "akti në lidhje me paaftësinë paguese", i cili passjell se të gjitha detyrimet e lindura në bazë të kësaj kontrate, duke përfshirë edhe ato të pamaturuara, kompensohen sipas procedurës të përshkruar në shkronjën "g" të nenit 5 dhe më pas kryhet pagimi ose ekzekutimi i diferencës/shumës së vetme që rezulton nga kompensimi. Secila palë ka detyrimin që të njoftojë menjëherë palën tjetër sapo vihet në dijeni për rrethanat, të cilat në bazë të nenit 5 shkronja "f" përbëjnë "akt në lidhje me paaftësinë paguese". Pala që ka të drejtën për të vënë në zbatim të detyrueshëm "netting" i dërgon palës tjetër një kërkesë për ekzekutimin vullnetar brenda 3 (tre) ditëve pune, të detyrimeve të përllogaritura sipas kësaj të fundit.
b) në rastet kur njëra nga palët dështon të kryejë në datën e duhur ndonjë pagesë ose dorëzim/transferim të pronësisë së titujve sipas kësaj kontrate dhe një dështim i tillë zgjat 3 (tre) ditë pune pas ditës kur është njoftuar me shkrim për këtë qëllim nga pala tjetër; dhe
c) në rastet kur njëra nga palët dështon të sigurojë ose të kthejë në kohën e duhur kolateralin e kërkuar për t'u siguruar ose kthyer prej këtij në bazë të kësaj kontrate ose kur mjetet për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve janë të pamjaftueshme në bazë të kontratës.

Neni 14
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për të gjitha mosmarrëveshjet, që mund të lindin midis palëve nga zbatimi i kontratës, palët mund t'i drejtohen Qendrës së Ndërmjetësimit dhe Arbitrazhit Tregtar ose në rast të kundërt organi kompetent për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 15
Kohëzgjatja

Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe i shtrin efektet e saj, duke filluar nga data 13.02.2010, për një periudhë të pacaktuar kohe.

Neni 16
Ndryshimet e kontratës

Kontrata mund të ndryshohet vetëm me shkrim, me vullnetin dhe me pëlqimin e palëve.

Kontrata, pasi lexohet nga palët, nënshkruhet me vullnetin e tyre të lirë e të pavarur në 4 (katër) kopje me vlerë të barabartë ligjore, ku secila nga palët mban 2 (dy) kopje.

Për Bankën e Shqipërisë:	Për Bankën/Degën e Bankës
Zoti_____	Zoti _____
Drejtor i Departamentit të Operacioneve Monetare	_____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr.16, datë 10.03.2010

PËR
MIRATIMIN E PROCEDURËS SË VEÇANTË PËR PROKURIMIN E OBJEKTIT "ABONIMI PRANË NJË AGJENCIE RENDITJEJE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat "c" dhe "g" të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të paragrafit të dytë të nenit 3 dhe nenit 45, shkronja "dh", të rregullores "Për procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë", miratuar me vendimin nr.81, datë 15.11.2006 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, i ndryshuar, dhe me propozim të Kryetarit të Entit Prokurues dhe Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë realizimin e objektit të prokurimit "Abonimi pranë një agjencie renditjeje" me procedurë prokurimi të drejtëpërdrejtë me agjencinë e renditjes Standard & Poor's, sipas dispozitave të aplikueshme për procedurën prokurim i drejtpërdrejtë, në bazë të rregullores "Për procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë" miratuar me vendimin nr. 81, datë 15.11.2006 të Këshillit Mbikëqyrës, i ndryshuar.

2. Të miratojë realizimin e objektit të prokurimit "Abonimi pranë një agjencie renditjeje" për një kohëzgjatje 3 (tre) vjeçare.

3. Të miratojë fondin e nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit "Abonimi pranë një agjencie renditjeje", jo më shumë se 40.000 euro.

4. Ngarkohet Departamenti i Administrimit, Departamenti i Operacioneve Monetare dhe Departamenti i Kontabilitetit dhe Financës me zbatimin e këtij vendimi.

5. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI	KRYETARI
YLLI MEMISHA	ARDIAN FULLANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 17, datë 10.03.2010

PËR
MIRATIMIN E DELEGIMIT TË KOMPETENCËS "PËR NËNSHKRIMIN E DOKUMENTACIONIT TEKNIK NË ZBATIM TË MARRËVESHJES NDËRMJET BANKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË "MASTERCARD INTERNATIONAL INC""

Në bazë dhe për zbatim të nenit 53, paragrafi i fundit i ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, me propozim të Guvernatorit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të autorizojë Drejtorin e Departamentit të Sistemeve të Pagesave të nënshkruajë dokumentacionin teknik të nevojshëm për zbatimin e marrëveshjes "Për shërbimin e shlyerjes në monedhën kombëtare për MasterCard", ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe shoqërisë "MasterCard International Inc. ".

2. Ngarkohet Departamenti i Sistemeve të Pagesave me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI	KRYETARI
YLLI MEMISHA	ARDIAN FULLANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 18, datë 10.03.2010

PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN "PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT TË DREJTPËRDREJTË PËR BLERJEN DHE MARRJEN ME QIRA TË AMBIENTEVE TË REJA PËR NEVOJAT E BANKËS SË SHQIPËRISË"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat "c" dhe "g" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe me propozim të Departamentit të Administrimit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e pikës 5 të vendimit nr. 56, datë 29.08.2008 "Për miratimin e përdorimit të procedurës së prokurimit të drejtpërdrejtë për blerjen dhe marrjen me qira të ambienteve të reja për nevojat e Bankës së Shqipërisë" i ndryshuar, sipas përmbajtjes së mëposhtme:
   "Afati kohor i realizimit të procedurës së prokurimit për objektin e prokurimit të përcaktuar në shkronjën "a", pika 2 të këtij vendimi, të jetë jo më shumë se 24 (njëzetë e katër) muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi".

2. Ngarkohet Departamenti i Administrimit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI — KRYETARI

YLLI MEMISHA — ARDIAN FULLANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 21, datë 24.03.2010

PËR
MBAJTJEN E PANDRYSHUAR TË NORMËS SË INTERESIT TË MARRËVESHJEVE TË RIBLERJES DHE TË ANASJELLTA TË RIBLERJES

Në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" të ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 5, 25 për qind, normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes (repo dhe repo të anasjellta).

2. Ngarkohen Departamenti i Politikës Monetare dhe Departamenti i Operacioneve Monetare me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI	KRYETARI
YLLI MEMISHA	ARDIAN FULLANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 22, datë 24.03.2010

PËR
DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË SHTESË NGA BANKA INTESA SANPAOLO ALBANIA SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja "a", nenit 43, shkronjat "c" dhe "e" të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar; të nenit 23, pikat 1 dhe 3, nenit 24, pika 1, shkronja "ç", nenit 54, pika 2, shkronja "e" dhe nënpika "i" të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të nenit 45 të ligjit nr.9879, datë 21.02.2008 "Për titujt", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për kryerjen nga Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a. të veprimtarisë financiare shtesë, si më poshtë:
- "Ndërmjetësimi për transaksionet monetare të marrjes në kujdestari, shërbimet depozituese dhe të besimit".

2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të kryer ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës të Bankës Intesa Sanpaolo Albania sh.a., sipas pikës 1 të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI	KRYETARI
YLLI MEMISHA	ARDIAN FULLANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr. 23, datë 24.03.2010

PËR
DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË SHTESË NGA BANKA E TIRANËS SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja "a", nenit 43, shkronjat "c" dhe "e" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar, të nenit 23, pikat 1 dhe 3, nenit 24, pika 1, shkronja "ç", nenit 54, pika 2, shkronja "e" dhe nënpika "i" të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të nenit 45 të ligjit nr.9879, datë 21.02.2008 "Për titujt", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për kryerjen nga Banka Tirana sh.a. të veprimtarisë financiare shtesë, si më poshtë:

- "Ndërmjetësimi për transaksionet monetare të marrjes në kujdestari, shërbimet depozituese dhe të besimit".

2. Ngarkohet Banka Tirana sh.a. që në mbledhjen e ardhshme të asamblesë së aksionerëve të kryejë ndryshimet e nevojshme në statutin e saj, në përputhje me ligjin nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe legjislacionin tregtar përkatës.

3. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të kryer ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës të Bankës Tirana sh.a., sipas pikës 1 të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit

Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI	KRYETARI
YLLI MEMISHA	ARDIAN FULLANI

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR VËLLIMI 12, NUMËR 1, SHKURT 2010

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 03, datë 27.01.2010 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes ".
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 08, datë 10.02.2010 "Për miratimin e "Dokumentit të politikës së investimit të fondit të pensionit në Bankën e Shqipërisë"".
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 09, datë 10.02.2010 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për fondin e pensionit suplementar të Bankës së Shqipërisë"".
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 10, datë 24.02.2010 "Për shfuqizimin e vendimit nr. 28, datë 25.03.2009 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë".
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 11, datë 24.02.2010 "Për realizimin e objektit të prokurimit "Shërbim i dy terminaleve të reja të informimit dhe tregtimit financiar"".
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 12, datë 24.02.2010 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes".

Botuar nga: Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.
Tel : 355-4-2222230; 2235568; 2235569;
Faks: 355-4-2223558
www.bankofalbania.org
E-mail: public@bankofalbania.org
Tirazhi: 300 kopje
Shtypur në shtypshkronjën *AdelPRINT*.